




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**KOMUNA E SUHAREKËS**  
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



**Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim**

**Data: 01.07.2022**

**Numri i vrojtimit të lejes:**

**07 Nr.347/350-35164**

-Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së kompanisë Telekom i Kosovës SHA.- dega Prizren, Komuna Prizren, me 07 Nr.350-35164 të datës 14.06.2022, në të cilën kërkon dhënien e lejes për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një shtandi mobil për prezantim të produkteve dhe ofertave verore të kompanisë “ VALA “, në bazë të Rregullores për Tarifatat, Ngarkesat dhe Gjohat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 dhe Rregullores - 01 Nr. 16-4719 dt. 30.06.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private, lëshon këtë:

**P Ë L Q I M**

| Ky dokument lëshohet për: |                                                  |                  |                                                                                |
|---------------------------|--------------------------------------------------|------------------|--------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:                     | <b>Telekomi i Kosovës SHA.<br/>Dega Prizren.</b> | Nr. Personal     |                                                                                |
| Adresa:                   | Prizren                                          | Telefoni:        |                                                                                |
| Email :                   |                                                  | Kërkesa<br>Bazë: | Pëlqim - për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një shtandi mobil. |

**Përshkrimi:**

- **I LEJOHET** - Telekomit të Kosovës SHA.- dega Prizren, Komuna Prizren, - shfrytëzimi i hapsirës publike për vendosjen e një shtandi lëvizës (mobil) - për prezantim të produkteve dhe ofertave verore të kompanisë “Vala dhe Telekom ” në qytetin e Suharekë .

-Ushtrimi i aktivitetit, vendosja e një objekti të përkohshëm - shtand lëvizës (mobil) - për promovim të produkteve dhe ofertave të kompanisë “Vala dhe Telekom“ do të bëhet në parcelën kadastrale Nr.2784-1, pasuri shoqërore, zona kadastrale Suharekë, në rrugën “Brigada-123“ - në vendin e quajtur sheshi “Fadil Vata“ në Suharekë .

-Shfrytëzimi i hapësirës publike për aktivitetet e kompanisë dhe vendosja e objektit të përkohshëm të cekur më lartë, është me karakter të përkohshëm dhe me datë të caktuar: **dt. 22.06.2022** deri më **01.09.2022**.

- Investuesi gjegjësisht shfrytëzuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër dhe pas përfundimit ta kthejë në gjendjen e mëparshme .

**A r s y e t i m**

Pranë Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit të Komunës së Suharekës ka parashtruar kërkesë Telekomit të Kosovës SHA.- dega Prizren, Komuna Prizren, - në të cilën ka kërkuar pëlqim për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e një shtandi lëvizës (mobil) - për prezantim të produkteve dhe ofertave verore të kompanisë “Vala dhe Telekom” në parcelën kadastrale Nr. 02784-1, pasuri shoqërore, zona kadastrale Suharekë, në rrugën “Brigada-123“ - vendi i quajtur sheshi “Fadil Vata“ në qytetin e Suharekës .

- Ky organ pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkëngjitura, ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës mundë të i jepet leja përkatësisht **PËLQIMI** për zhvillimin e aktiviteteve të lartpërmendura.

Paqe Inga2

**Udhëzime Juridike :** Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese – MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtit .

**Pëlqimi i dërgohet:**

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

**Drejtori i Drejtorisë:**

**Visar Kuçi**

